



**DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS**  
ZYRA E PROGRAMEVE, MESIMDHENIES & VLERESIMIT  
440 North Broad Street  
Philadelphia, PA 19130

## **Veçoritë e Testit Keystone/PSSA dhe Sistemimet, 2017-18**

- Do të ketë disa mundësi për të *gjithë* nxënësit gjatë testimit, të tilla si të pasurit e një kohe më të gjatë dhe leximi me zë të lartë, në të gjitha lëndët si në matematikë, shkencë, Algjebra 1, Biologji dhe në disa pjesë të vlerësimit ELA, etj.
- Mundësitë në dispozicion të *gjithë* nxënësve quhen “veçoritë e testit”.
- Opsionet e mundëshme për nxënësit Sp. Ed., ELL, dhe ata me Plan 504 janë të nevojshme që t'i lejojnë ata të marrin pjesë në testimet nëpërmjet të ashtuquajturave “sistemime”. Kështu që sistemimet janë praktika, që ofrojnë qasje të barabarta në teste për këta nxënës.
- Sistemimet ndahen në 4 kategori: Prezantimi, Përgjigja, Ulja (sistemimi) dhe Koha e Testit.
- Të gjitha sistemimet që janë për testet Keystone, janë të vlefshme edhe për ato PSSA.
- **Është me rëndësi të theksohet, se ndonëse disa sistemime janë të duhurat për qëllime mësimore, mund të mos jenë korrekte në testimet e standardizuara.**
- Sistemimet duhet të jenë në përputhje me nevojat e nxënësve; nxënësit duhet të jenë të gatshëm t'i përdorin ato; dhe nxënësit duhet të përfshihen në zgjedhjen e këtyre sistemimeve (Shih “Burimet Shtesë” në Udhëzimet e Sistemeve Keystone dhe PSSA për vitin 2018\*).
- Praktika më e mirë për zgjedhjen e sistemimeve në kohën e testimit, është përdorimi rëndom i këtyre praktikave me nxënësit dhe dokumentimi i dobisë së përdorimit, përpara testimit. Nuk rekomandohet përdorimi i sistemimeve në testimet, në rastet kur ato nuk janë përdorur rregullisht.

### **Sistemimet që janë VETEM për Nxënësit ELL**

Janë të lejuara në mënyrë specifike tre sistemime *vullnetare* për nxënësit ELL

- 1) Fjalor përkthimi Fjalë-Fjalë, pa përcaktime dhe pa fotografi shoqëruese dhe akses në internet ---- lejohen në Algjebra 1 dhe Biologji në testet Keystone; dhe Matematikë e Shkencë VETEM në PSSA (E vlefshme për të GJITHE ELL pavarësisht numrit të viteve në USA)
- 2) Përkthyes të Kualifikuar \*\* ---- lejohen në Algjebra 1 dhe Biologji në testet Keystone dhe Matematikë e Shkencë, në PSSA dhe Analizat e Tekstit (TDA) seksionin e ELA PSSA (E vlefshme VETEM për ELL që kanë më pak se tre vite në shkollat e USA)
- 3) Broshurat pyetje përgjigje në Spanjisht/Anglisht për testet ---- lejohen në Algjebra 1 dhe Biologji në testet Keystone dhe Matematikë e Shkencë për PSSA (E vlefshme VETEM për ELL që kanë më pak se tre vite në shkollat e USA)

Të tre sistemimet e mësipërme për nxënësit ELL- NUK janë për nxënësit e viteve të fundit.

### **Për më tepër informacion rreth Sistemimeve dhe Veçorive të testeve, ndiqni linkun në vazhdim dhe shikoni seksionin e Sistemimeve në Testim:**

<http://www.education.pa.gov/Documents/K-12/Assessment%20and%20Accountability/PSSA/Accommodations/2018%20Accommodations%20Guidelines%20Handbook.pdf>

\*\*Për rolin e përkthyesve dhe atyre me pamje shikoni në linkun e mësipërm dhe klikoni në: Accommodations Guidelines 2018 PSSA and Keystone Exams for ELs (page 6).